# 2.1 Dallimet metodike në mes të mësimit dhe të instruktimit



Ekziston një ndërlidhshmëri në mes të mësimit teorik profesional dhe të mësimit praktik profesional. Por gjatë ndërmjetësimit të teorisë dhe praktikës kemi dallim në vendosjen e theksit. Derisa mësimi kryesisht sqaron lidhshmëritë teorike, instruktimi përqëndrohet në sqarimet dhe aplikimet praktike.Në përgatitjen e strukturës, zbatimit, metodikës dhe kontrollit të mësimit dhe instruktimit duhet pasur parasysh një sërë dallimesh.

*Para se të shohim një instruktim në punë, dëshiroj të ju përkujtoj dallimet në mes të orës mësimore (teoria) dhe instruktimit (praktika)!*

## Dallimet mes orës mësimore (teoria) dhe instruktimit (praktika)

| Instruktimi (praktika) | Ora mësimore (teoria) |
|---|---|
| **Nërmjetësimi pranë vendit të punës (në punëtori)**<br><br>-Vrojtimit i detajeve<br>-Shkathtësitë e duhura dhe procesi i punës<br>-Në radhë të parë zbatimet vepruese | **Ndërmjetësimi në klasë i njohurive të përgjithshme**<br><br>-Vështrimet dhe njohuritë e domosdoshme<br>-Në radhë të parë teoria |
| **Tregon materialin mësimor**<br><br>-Sistematikisht në zbatim<br>-Zakonisht nën presion kohor<br>-Përgatitje afatshkurtëra | **Trajton sistematikisht, në vazhdime, materialin mësimor**<br><br>-Thjeshtësuar dhe me përgatitje dialektike<br>-Zakonisht pa presion kohor<br>-Planifikim afatgjatë |
| **Shërbehen kryesisht metodat e**<br><br>-Demonstrimit<br>-Sqarimit<br>-Imitimit | **Shërbehen kryesisht metodat e**<br><br>-Ligjërimit<br>-Përpunimit |
| **Vlerësimi i suksesit**<br><br>-Me anë të provave të punës<br>-Me anë të zgjidhjeve të detyrave<br>-Me anë të testeve | **Vlerësimi i suksesit**<br><br>-Me anë të klauzurave (test)<br>-Me anë të provimeve me gojë |